

NGA **EDUARD SHALSI**
MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI I PROFESIONEVE JANË THELBËSORE NË SIGURIMIN E TRANSPARENCËS SË BIZNESIT

OPINION

**Reforma në fushën
e profesionit të kontabilistit**

SOTIRAQ DHAMO

**Fiskalizimi,
problemet dhe sfidat**

BUJAR BENDO AUDITUES LIGJOR

**Fiskalizimi – Sfidat
dhe Mundësitë e Zbatimit**



4 Mbiqëqyrja dhe kontrolli i profesioneve janë thelbësore në sigurimin e transparencës së biznesit

Sigurimi i raporteve financiare të drejta lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ata të cilët i përgatisin këto raporte si dhe ata që i certifikojnë, prandaj dhe mbiqëqyrja dhe kontrolli i profesioneve të kontabilistit të miratuar si dhe të audituesit ligjor janë thelbësore në sigurimin e transparencës së biznesit.

Nga Eduard Shalsi

Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

6 Reforma në fushën e profesionit të kontabilistit

Si ka qenë ecuria e procesit të verifikimit të veprimtarisë së kontabilistëve të miratuar. Rezultatet, problematikat e konstatuara në dosjet e analizuara. Sugjerimet e subjekteve KM gjatë intervistimit të tyre. Sugjerimi për miratimin e çmimeve "dyshe" për shërbimet e ofruara për rregullimin e tregut në të cilin ata operojnë.

11 Sistemi parandalues për pastrimin e parave dhe goditja e financimit të terrorizmit

Një pasqyrë e shkurtër e situatës në Shqipëri, ndërlidhja e profesionit të kontabilistit dhe audituesit. Bashkëpunimi i autoriteteve me shoqatat e audituesve dhe kontabilistëve është kyç në realizimin e misionit dhe arritjes së efektivitetit.

Nga z. Elvis Koçi
Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

14 Besueshmëria e Raportimit Financiar si domosdoshmëri e zhvillimit të Bursës

Tregjet financiare janë institucione dhe mekanizma të ndërtuara dhe që funksionojnë bazuar mbi besimin që krijojnë tek përdoruesit dhe investuesit. Për këtë arsye të gjithë operatorët, si në anën e kërkesës ashtu edhe në anën e ofertës për kapitale në tregun financiar, e kanë shumë të nevojshme të gëzojnë besueshmërinë e palëve të interesuara.

Nga z. Artan Gjergji

Drejtor Ekzekutiv, Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

18 Rëndësia e raportimit të drejtë për tregjet financiare

Besueshmëria e raportimit financiar si domosdoshmëri e zhvillimit të tregjeve financiare dhe në veçanti e Bursës, perspektiva për të ardhmen. Cilësia e

raportimit financiar përbën edhe një nga parakushtet për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe sigurimit të efciencës së këtyre tregjeve

Nga Patris Poshnjari

Kryespecialiste, Drejtoria e Mbiqëqyrjes së Tregut të Kapitaleve, AMF

20 Kostot e mëdha të tre dekadave kaosit në raportimin financiar

Është koha për të lënë përfundimisht pas, tre dekadat e kaosit dhe pasigurisë në këtë industri sepse nga kjo do të përfitojnë të gjithë. Përfitojnë qytetarët, biznesi, industria financiare dhe vetë profesionistët e këtij sektori

22 Rëndësia e raportimit financiar në procesin e kredithënies

Vendimi për moslejimin të themi "të dy balance", siç njihet në praktikë, bëri ndryshimin dhe krijon presion mbi shoqëritë tregtare për dokumentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare; ai vendos rregull në marrëdhëniet subjekt-tatime dhe subjekt – bankë.

Nga prof. Spiro Brumbull

Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së bankave

24 Fiskalizimi, problemet dhe sfidat

Sistemi i fiskalizimit përbën një risi dhe një zhvillim cilësor në drejtim të administrimit të sistemit tatimor në vendin tonë. Implementimi i tij mund të ishte bërë në mënyrë më të matur dhe duke mundur kohën e nevojshme palëve që prekën nga ky sistem si për të njohur atë ashtu dhe për të mundur implementimin e saktë të tij.

Prof. Dr.. Sotirag Dharmo

31 Sistemi i ri do të ndryshojë mënyrën se si do të bëjmë biznes

A ishte e nevojshme në këtë moment një reformë e tillë?

Nga Arben Shkodra

Sekretar i Përgjithshëm i Bashkimit të Prodhuesve Shqiptar

33 Fiskalizimi – Sfidat dhe Mundësitë e Zbatimit

Vlerësimi i gjendjes së bizneseve dhe ecurisë së procesit tregon për një dështim të sigurt të tij. Prandaj, do të ishte më mirë që procesi i nisur të rristurohet dhe të shtrihet në një periudhë më të gjatë kohore dhe të përfshijë ato kategori biznesesh dhe transaksionesh për të cilat fiskalizimi kontribuon në përmirësimin e performancës fiskale

Nga Bujar Bendo

Auditues ligjor

38 Auditimi në Shqipëri gjatë pandemisë Covid 19

Një vështrim përmbledhës mbi sfidat që ndeshën audituesit dhe zhvillimet e së ardhmes.

Nga Enida Cara, FCCA, AL

Drejtuuese e Shërbimeve të Auditimit dhe Këshillimit të Sigurisë Financiare
Deloitte Audit Albania shpk

OPINION I PAVARUR

Besueshmëria e Raportimit Financiar si domosdoshmëri e zhvillimit të Bursës

Tregjet financiare janë institucione dhe mekanizma të ndërtuara dhe që funksionojnë bazuar mbi besimin që krijojnë tek përdoruesit dhe investuesit. Për këtë arsye të gjithë operatorët, si në anën e kërkesës ashtu edhe në anën e ofertës për kapitale në tregun financiar, e kanë shumë të nevojshme të gëzojnë besueshmërinë e palëve të interesuara.



NGA Z. ARTAN GJERGJI
DREJTOR EKZEKUTIV
BURSA SHQIPTARE E TITUJVE ALSE SH.A.

Tregu i kapitaleve në vend ka pasur një zhvillim mjaft cilësor në vitet e fundit, jo vetëm për shkak të shtimit të fondeve të investimit dhe krijimit të Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, por edhe për shkak të pëmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator për tregun e kapitaleve dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive e alternative. Legjislacioni i ri ka bërë të mundur një përafrim të dukshëm me Direktivat e Bashkimit Europian për industrinë e titujve dhe fushën e investimeve, duke krijuar të gjithë ambientin e nevojshëm për një zhvillim më të vrullshëm të tregut të kapitaleve në të ardhmen e afërt.

Për dekada me radhë, zhvillimi i tregut të kapitaleve ka

qenë i pjesshëm me një fokus të qartë tek tregu i titujve të Qeverisë, ndërkohë që ka qenë thuajse i pamundur shfrytëzimi i këtij tregu nga biznesi privat për rritjen e kapitalit. Kjo ka ardhur kryesisht për disa arsye:

- Mos kanalizimi i procesit të privatizimit nëpërmjet tregut të kapitaleve dhe listimit të ndërmarrjeve shtetërore në bursë,
- Mungesa e infrastrukturës së plotë institucionale e sidomos një depozitari qendror të titujve (e ashtuquajtura “hipoteka e titujve”), si dhe
- Tendenca e biznesit për evazion fiskal, çka përkthehet në një transparencë financiare minimaliste të pasqyrave financiare për publikun.

Parë sot pas një çerek shekulli, Shqipëria pothuaj e ka humbur trenin e listimit në bursë të aksioneve të ndërmarrjeve shtetërore, për shkak se procesi i privatizimit pothuajse ka përfunduar, por edhe ato subjekte të mbetura (*OSHEE, KESH, OST, Posta Shqiptare* etj.) konsiderohen si investime strategjike dhe normalisht që ekzekutivi ka gjithnjë plane dhe pritshmëri madhore për to. Ndërkohë janë bërë shumë hapa para në drejtim të plotësimit të infrastrukturës së tregut të kapitaleve pasi tashmë:

- Kemi më shumë instrumente financiare, përshtirë edhe ato të emetuara nga biznesi privat siç janë obligacionet korporative të emetuara me ofertë private (*jo të hapura për publikun e gjerë, por të kufizuara tek një grup i përzgjedhur investorësh*),
- Kemi më shumë ndërmjetës financiarë që përbëjnë edhe shtyllën kurrizore të tregut të kapitaleve siç janë firmat e brokerimit, bankat që tregtojnë tituj,

kujdestarët e titujve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve, shoqëritë e administrimit të fondeve, këshilltarët e investimeve etj.

- Tashmë është krijuar dhe depozitari i titujve me emrin Regjistrari Shqiptar i Titujve ALREG, i cili është licencuar si nga Banka e Shqipërisë (BSH) ashtu edhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të ofruar shërbimet e regjistrimit, depozitimit, klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve në tituj të ekzekutuar në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE.

Sa i përket transparencës dhe raportimit financiar, Shqipëria ka bërë një punë të lavdërueshme në drejtim të konsolidimit të arkitekturës ligjore dhe institucionale. Kështu:

- Është bërë punë e konsiderueshme sidomos në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullativ dhe harmonizimit të tij me direktivat e BE-së,¹
- Është mjaft i rëndësishëm dhe i mirëpritur bashkëpunimi mes Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë për pranimin vetëm të pasqyrave financiare zyrtare, si element për vlerësimin e rrezikut të bizneseve në kërkim të një kredie nga sektori bankar, pasi rrit zbatueshmërinë e ligjit dhe ndryshon pozitivisht mendësinë e biznesit për transparencën financiare,
- Është bërë shumë punë në drejtim të standardizimit dhe konsolidimit institucional duke qendëruar dhe rritur fuqinë e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP), pa lënë mënjanë rëndësinë e enteve të tjera që përfaqësojnë interesat e industrisë (si IEKA, IAS etj.).

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM RAPORTIMI FINANCIAR

Tregjet financiare janë institucione dhe mekanizma të ndërtuara dhe që funksionojnë bazuar mbi besimin që krijojnë tek përdoruesit dhe investuesit. Për këtë arsye të gjithë operatorët, si në anën e kërkesës ashtu edhe në anën e ofertës për kapitale në tregun financiar, e kanë shumë të nevojshme të gëzojnë besueshmërinë e palëve të interesuara.



- **Kërkesa për Kapitale (Emetuesit e titujve)** – bizneset apo çdo subjekt që ka nevojë të zgjerojë aktivitetin e tij dhe për rrjedhojë të gjejë burime financimi, për t'ia arritur këtij qëllimi, mund të përdorë tregun e kapitaleve nëpërmjet emetimit të titujve të kapitalit (*aksioneve*) ose titujve të borxhit (*obligacioneve korporative*). Në ndryshim nga sektori bankar, në tregun e kapitaleve, emetuesit mund të gjenerojnë fonde në vlera të mëdha, me kosto të ulëta dhe me afat shumë të gjatë. E në mënyrë që të jenë sa më të besueshëm në sytë e investitorëve, u duhet padyshim të kenë një nivel shumë të lartë të transparencës dhe besueshmërisë financiare (*disclosure*).
- **Oferta e Kapitaleve (Investuesit e titujve)** – një ndër alternativat që kanë kursimtarët me fonde të lira (*të pa-angazhuara*) në ekonominë e një vendi, është padyshim edhe investimit (*ofrimi i fondeve*) në tituj apo siç njihet ndryshe investimit i portofolit. Në këtë formë investuesit, përzgjedhin mes alternativave afatshkurtra dhe afatgjata, me ose pa rrezik, me kthim (*përfitim*) të lartë ose të ulët, si dhe në bazë të qasjes (*pëlqimit*) që kanë ndaj nivelit të rrezikut ku angazhojnë fondet e tyre. Padyshim që në këtë proces, investuesit mund të krijojnë edhe një portofol miks me asete dhe tituj me nivele rrezik-përfitim të ndryshme, duke diversifikuar probabilitetin e rrezikut të investimit. Në gjithë këtë proces është shumë e rëndësishme që informacioni për investuesin të jetë sa më i detajuar, i saktë dhe i shpërndarë në mënyrë publike e të njëtrajtshme tek të gjithë. Kjo sepse u

¹ Neni 5, pika 2 e ligjit nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", detyron njësitë ekonomike me ndikim publik (ndër të cilat njësitë e listuara në bursë), të përgatisin pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

jep mundësinë investuesve të jenë të qartë në lidhje me komponentët që duhet të marrin në konsideratë (*afatin e gjatë, rrezik, përfitim etj.*) në mënyrë të tillë që të kenë një vendimarrje sa më të saktë bazuar në qasjet e tyre ndaj rrezikut. Pikërisht për këtë arsye, informacioni i saktë në lidhje me të dhënat financiare të bizneseve, titujt e të cilëve do të investojnë (*blejnë*) është i një rëndësie të veçantë për investorët.

A ËSHTË I MJAFTUESHËM RAPORTIMI FINANCIAR PËR INVESTUESIT

Në një botë gjithnjë e më globale, si dhe në kushtet e një zhvillimi të jashtëzakonshëm të teknologjisë dhe informacionit, zhvillimi i tregjeve financiare sa vjen e bëhet më kompleks duke rritur mundësitë e abuzuesve për mashtrime. Kjo është arsyeja pse nuk mjafton vetëm detyrimi për raportim financiar i subjekteve që rrisin kapitalin e tyre nëpërmjet listimit në bursë. Në 3-4 dekadat e fundit por sidomos pas krizës financiare të kompanive teknologjike (e ashtuquajtura "*dot.com bouble*")² ka një interes në rritje për elementë shtesë që kanë të bëjnë me aksesimin sa më të lehtë të këtij informacioni nga investorët si dhe me besueshmërinë e informacionit të publikuar.

- **Aksesimi i Informacionit Financiar** – është një element mjaft i rëndësishëm në tregun financiar. Kjo është arsyeja pse kuadri ligjor i tregut të kapitaleve në çdo vend e detyron Emetuesin e titujve që të publikojë çdo informacion që mund të ndikojë çmimin (*price sensitive*) si dhe t'ua bëjë sa më lehtësisht të aksesueshëm publikut investues marrjen e informacionit në lidhje me biznesin në fjalë, sidomos informacionin financiar (*pasqyrat financiare*). Kështu, të gjithë raportet financiare vjetore dhe/ose periodike duhet të publikohen ose nëpër media që kanë nivel të lartë shikueshmërie/lexueshmërie, ose në faqet zyrtare të internetit në mënyrë që të jenë lehtësisht



të aksesueshme nga investuesit dhe publiku. Gjithashtu, po aq i rëndësishëm sa vetë aksesimi është edhe koha (*timing*) e aksesimit, e cila duhet të jetë e njëtrajtshme për të gjithë publikun. Nëse shpërndarja e këtij informacioni nuk është e tillë, kjo mund të favorizojë disa investues në kushtet e marrjes së informacionit para të tjerëve. Kjo shpjegon faktin që pothuaj të gjithë bursat ku janë të listuara këto kompani, nuk mjaftohen vetëm me publikimin e informacionit financiar nga Emetuesi në media dhe në faqen zyrtare, por kërkojnë dërgimin e menjëhershëm të këtij informacioni në Bursë, në mënyrë që kjo e fundit ta publikojë atë në mënyrë të njëtrajtshme tek të gjithë investuesit që kanë si burim primar informacioni vetë bursën.

- **Besueshmëria e Informacionit Financiar** – një tjetër element i rëndësishëm që ndikon direkt vendimarrjen e investuesve është edhe besueshmëria e informacionit financiar të publikuar. Sa më i saktë dhe i pavarur të jetë ky informacion, aq më të qartë e ka rrezikun që merr mbi vete investuesi, duke e ndihmuar këtë të fundit të marrë vendime

² Nënkupton zhvillim mjaft të shpejtë të kompanive të kompanive që në bazën e aktivitetit të tyre kishin teknologjinë dhe informacionin, duke sjellë një mbiçmim (fryrje, balon) të çmimeve të këtyre kompanive. Ky fenomen përfundoi në fillim të viteve 2000' pas skandaleve të trukimit nga Arthur Andersen (kompania më e madhe e auditimit në botë) të pasqyrave financiare të disa kompanive të listuara në bursë (Enron dhe WorldCom) duke mashtruar qytetarët që kishin investuar kursimet e tyre në këto tituj.



në përputhje me pritshmëritë e tij dhe me qasjen që ka ndaj rrezikut. Në mënyrë që informacioni të jetë sa më i saktë dhe i besueshëm për investuesit, duhet që në radhë të parë të jetë informacioni i standardizuar (*i njëjti kut, e njëjta masë për të gjithë*) si dhe të jetë përgatitur e kontrolluar (*audituar*) në mënyrë profesionale e të pavarur. Standardizimi i informacionit u mundëson investuesve krahasimin e rrezikut të investimit në tituj të bizneseve të ndryshme me të njëjtën masë vlerësimi. Kurse profesionalizmi e pavarësia e përgatitjes së raportimit financiar (*audtimi ligjor*) shmang konfliktin e interesit që ka biznesi në drejtim të publikimit të të dhënave financiare, duke mbrojtur interesat e investuesve dhe rritur besueshmërinë tek të dhënat e paraqitura mbi paraqitjen e gjendjes financiare të Emetuesit.

RAPORTIMI FINANCIAR NË SHQIPËRI

Siç u tha edhe më lart, Shqipëria ka bërë mjaft hapa pozitivë në drejtim të rritjes së nivelit të publikimit të informacionit financiar.

- **Publikimi** – legjislacioni shqiptar e kërkon me detyrim publikimin e të dhënave financiare për njësitë ekonomike me ndikim publik (PIE). Deri në ditët e sotme ky legjislacionin është aplikuar për institucionet financiare në vend (*banka, shoqëri sigurimi, shoqëri të administrimit të fondeve etj*). Për shkak të mos-listimit në bursë ende të titujve të biznesit, ky legjislacion nuk ka gjetur zbatim për pjesën tjetër të PIE-ve. Fillimi i listimeve të titujve të parë të biznesit, proces që pritet të ndodhë brenda vitit 2021, do të testojë për herë të parë edhe zbatueshmërinë e detyrimit të publikimit të informacionit financiar nga këto subjekte.
- **Aksesimi** – janë bërë hapa përpara në këtë drejtim, pasi për shkak të një vullneti të qartë politik dhe për shkak të zhvillimit të teknologjisë dhe informacionit, aksesimi i informacionit financiar është lehtësuar shumë. Në këtë aspekt Shqipëria ka më shumë se një dekadë që është pararojë me pika kontakti (*kryesisht publike*) dhe të aksesimit të informacionit duke i publikuar në faqet zyrtare të QKB, BSH, AMF, INSTAT, OpenData Albania etj.
- **Standardizimi** – një punë e lavdërueshme është bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe institucione të tjera publike në këtë fushë për përkthimin, harmonizimin dhe zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (*SKK*) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (*SNRF*).
- **Besueshmëria** – është komponenti më i vështirë për t'u arritur, edhe pse po punohet shumë në këtë drejtim si nga rregullatorët (*BSH, AMF dhe BMP*) ashtu edhe nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Pavarësisht nga sa më sipër, duhet thënë që fillimi nga funksionimi normal i tregut të kapitaleve në vend dhe listimi i bizneseve në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE, do të jetë testi më i mirë për reformat e marra deri më tani. Zbatueshmëria e legjislacionit dhe praktikave më të mira në drejtim të raportimit financiar, do të ketë një ndikim pozitiv në drejtim të mbrojtjes së interesave të investitorëve, pasi do t'u mundësojë atyre një vendimarrje më të drejtë e në përputhje me pritshmëritë e tyre ndaj riskut dhe përfitimeve.

OPINION I PAVARUR

Rëndësia e raportimit të drejtë për tregjet financiare

Besueshmëria e raportimit financiar si domosdoshmëri e zhvillimit të tregjeve financiare dhe në veçanti e Bursës, perspektiva për të ardhmen. Cilësia e raportimit financiar përbën edhe një nga parakushtet për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe sigurimit të eficiencës së këtyre tregjeve

NGA **PATRIS POSHNJARI**,
KRYESPECIALISTE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGUT TË KAPITALEVE, AMF

Objekti kryesor i përgatitjes së pasqyrave financiare të njësive ekonomike është sigurimi i një informacioni të plotë financiar lidhur me pozicionin financiar, performancën financiare, flukset e mjeteve monetare apo ndryshimet në kapitalin e vet të këtyre njësive. Në këtë mënyrë, përdoruesit kryesorë të këtyre pasqyrave, që janë investitorët ekzistues apo potencialë, kreditorët, punonjësit e një kompanie apo analistët financiarë, bazuar në rezultatet e pasqyrave financiare mund të marrin vendimet e duhura lidhur me investimet që duhet të kryejnë.

Pra, informacioni i siguruar përmes raportimit financiar përbën edhe bazën për marrjen e vendimeve në investime në përputhje me objektivat e investitorit lidhur me kthimin nga investimi, nevojën për likuiditet apo riskun. Kështu kjo kategori personash e përdor informacionin financiar për të vendosur nëse duhet të blejë, të shesë apo të mbajë në portofolin e vet titujt e pronësisë (aksionet) apo instrumentet e borxhit të një kompanie të caktuar dhe nëse duhet t'u japin fonde këtyre kompanive.

Çmimet e aksioneve ndryshojnë si përgjigje ndaj disa variablave financiare që sigurohen pikërisht nga informacioni financiar, si fitimi neto, projeksionet e flukseve neto të ardhurave, aktivet neto, kthimi nga investimi, niveli i borxhit, të cilat ose merren direkt nga pasqyrat financiare ose derivohen prej tyre nëpërmjet



RËNDËSIA E INFORMACIONIT

Informacioni i siguruar përmes raportimit financiar përbën edhe bazën për marrjen e vendimeve në investime në përputhje me objektivat e investitorit lidhur me kthimin nga investimi, nevojën për likuiditet apo riskun. Kështu kjo kategori personash e përdor informacionin financiar për të vendosur nëse duhet të blejë, të shesë apo të mbajë në portofolin e vet titujt e pronësisë (aksionet) apo instrumentet e borxhit të një kompanie të caktuar dhe nëse duhet t'u japin fonde këtyre kompanive

përlllogaritjes së formulave, bazuar në rezultatet e pasqyrave financiare.

Ky fakt reflektohet edhe në Ligjin nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit", sipas të cilit shoqëria e listuar në Bursë duhet t'i bëjë menjëherë të ditur publikut çdo informacion,

për të cilin vihet në dijeni dhe që mund të ndikojë mbi çmimet, ka lidhje me shoqërinë ose me shoqëritë e saj të kontrolluara dhe do të kishte rëndësi materiale për vendimmarrjen e investitorit, përfshirë informacionin që është i nevojshëm për t'i dhënë mundësi publikut të vlerësojë pozicionin e shoqërisë dhe të shoqërive të saj të kontrolluara.

DOBISHMËRIA E INFORMACIONIT

Informacioni financiar i siguruar konsiderohet i dobishëm për marrjen e vendimeve në investime vetëm nëse ai është me rëndësi dhe i besueshëm, pra i tillë që në mënyrë të besueshme të japë një pamje të drejtë të realitetit ekonomik të kompanisë dhe pozicionit financiar të saj për periudhën e raportimit. Në këtë mënyrë realizohet efienca e tregut të kapitaleve, ku i gjithë informacioni reflektohet në çmimin e titullit, duke çuar në përputhjen e vlerës reale të atij titulli me çmimin e tij të tregut, dhe njëkohësisht në alokimin e drejtë të kapitalit drejt sektorëve më produktivë të ekonomisë. Për këtë arsye edhe në Shqipëri shoqëritë e listuara janë subjekt i detyrimit për raportim financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNRF), standarde këto të cilat aplikohen në rreth 120 vende, përfshirë edhe vendet e BE-së. Kjo kërkesë e Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit" është parashikuar në përputhje me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Ligjin nr. 1091, datë 05/03/2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", sipas të cilit njësitë me interes publik siç janë të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë; bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë; shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar; etj. duhet të raportojnë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Edhe evidencat empirike bazuar në një sërë studimesh të ndërmarra tregojnë korelacionin pozitiv ndërmjet aplikimit të standardit ndërkombëtar SNRF (IFRS) dhe progresit në zhvillimin e tregut të kapitaleve. Ky fakt vlen edhe më shumë për vendet më pak të zhvilluara dhe me

RËNDËSIA PËR INVESTITORËT

Aplikimi i SNRF (IFRS) dhe fakti që pasqyrat financiare të kompanive bëhen të krahasueshme ndikon pozitivisht edhe në zgjerimin e bazës së investitorit përmes tërheqjes së investitorit të huaj si rezultat i përgatitjes së pasqyrave financiare me baza të krahasueshme.

problematika në zhvillimin e tregut të kapitaleve. Në këto kushte aplikimi i standardeve IFRS për Emetuesit përbën domosdoshmëri dhe është i lidhur drejtpërdrejt me rritjen e besimit të investitorit shqiptar dhe të huaj. Në kushtet e një ekonomie globale, me transaksione të shumta ndërkombëtare dhe lëvizje të lirë kapitali, është i domosdoshëm aplikimi i SNRF-ve.

STANDARDET

Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar sjellin transparencë dhe eficiencë në tregjet financiare duke nxitur krahasueshmërinë e performancës së kompanive kudo në botë dhe duke ndihmuar kështu investitorin në diversifikimin e portofolit të tij. Aplikimi i SNRF (IFRS) dhe fakti që pasqyrat financiare të kompanive bëhen të krahasueshme ndikon pozitivisht edhe në zgjerimin e bazës së investitorit përmes tërheqjes së investitorit të huaj si rezultat i përgatitjes së pasqyrave financiare me baza të krahasueshme. Në këto kushte aplikimi i standardeve ndërkombëtare në përgatitjen e pasqyrave financiare ndikon ndjeshëm në uljen e kostos së kapitalit për kompanitë dhe në rritjen e likuiditetit në tregun e kapitaleve.

Jo vetëm detyrimi për raportim financiar, por mbi të gjitha cilësia e raportimit financiar përbën edhe një nga parakushtet për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe sigurimit të eficiencës së këtyre tregjeve. Në këto kushte edhe aftësia e një analisti financiar apo investitori për të vlerësuar cilësinë e informacionit financiar të raportuar është e rëndësishme, pasi një analist apo investitor që arrin të identifikojë raportimin financiar të cilësisë së lartë ka më shumë besim në analizat mbi bazën e raporteve financiare dhe në rezultatet e vendimeve për investim.

DEBAT ME EKSPERTËT

Rëndësia e raportimit financiar në procesin e kredidhënies

Vendimi për moslejimin të themi “të dy balance”, siç njihet në praktikë, bëri ndryshimin dhe krijon presion mbi shoqëritë tregtare për dokumentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare; ai vendos rregull në marrëdhëniet subjekt-tatime dhe subjekt – bankë.



NGA PROF. **SPIRO BRUMBULLI**
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I SHOQATËS SË BANKAVE

Domosdoshmëria e raportimit financiar ka lindur si një kërkesë ligjore e qeverisë. Qeveria detyroi shoqëritë tregtare të përgatisin dhe të dorëzojnë pasqyrat financiare për të llogaritur saktë detyrimet që duhet të paguajnë ndaj shtetit.

Kjo domosdoshmëri për shtetin ka rëndësi edhe për tregun dhe ekonominë. Pa raportimin financiar nuk ka informacion financiar. Prandaj, përveç rëndësisë për nevojat e llogaritjes së detyrimeve tatimore, raportimi financiar është i rëndësishëm edhe për:

- aksionmbajtësit, kreditorët dhe bizneset e tjera sepse japin një ide mbi integritetin financiar të subjektit tregtar dhe besueshmërinë ndaj tij:

- marrje vendimi për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit sepse përmban informacionin e nevojshëm mbi të cilin realizohet vendimarrja.

Nga ana tjetër, kredidhënia është një proces që bazohet te analiza e të dhënave. Këto të dhëna janë të përmbledhura dhe të pasqyruara në grupin e dokumenteve të raportimit financiar: pasqyra e gjendjes, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhës së parasë dhe pasqyra e lëvizjes së kapitalit. Këto dokumente janë baza për një analizë të thelluar.

Analiza financiare i jep përgjigje një grupi pyetjesh për aspekte të veprimtarisë financiare të subjektit duke i siguruar vendimarrësve një pamje të saktë dhe sa më gjithëpërfshirëse nëpërmjet treguesve të përlllogaritur (KPI) dhe përfundimeve mbi bazën e tyre. Nëse baza ku mbështeten këto analiza nuk është e saktë, atëherë edhe treguesit do të jenë të gabuar dhe, për pasojë, edhe vendimarrja do të jetë e gabuar.

Prandaj saktësia, vërtetësia dhe besueshmëria e pasqyrave financiare është pika e nisjes për çdo referim, vendim, vlerësim apo rekomandim. Kjo ka vlerë të veçantë edhe në rastin e shqyrtimit të një kërkesë për kredi. Duke qenë se bankat janë në presion nga aksionarët për rritjen e vlerës së pasurisë, të kreditimit të ekonomisë, faktorë të stabilitetit financiar të vendit - ato janë të interesuara që rastet për trajtim me kredi të jenë sa më të mira, sa më të besueshme dhe sa më të kthyeshme. Ky besim dhe niveli i riskut i marrë përsipër sigurohen nga analiza që bëhet mbi bazën e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të raportimit financiar ndërtohen mbi bazën e standardeve, lokale apo ndërkombëtare, në varësi të qëllimit të përdorimit dhe kërkesave ligjore.



NGA VITI 2018

Pasqyrat financiare që bankat marrin në konsideratë janë të njëjta me ato që shoqëria tregtare dorëzon në zyrat e tatim-taksave. Kjo e ka vendosur bankën në pozitë më relaksuese, sepse nuk duhet të ribëjë grupin e pasqyrave financiare, por të fokusohet në analizë të dokumenteve të dorëzuara duke i konsideruar të vërteta. Kjo shkurton ciklin e analizës dhe kohën e vendimarrjes.

Pasqyrat financiare mund të kenë ndryshime që rrjedhin nga natyra e standardit të përdorur dhe këto janë mëse të justifikuara, janë të drejta dhe të pranueshme. Por mangësitë në përpilimin e pasqyrave financiare brenda një standardi janë të papranueshme dhe në praktikë sjellin pasoja me rrezik të lartë: si për shtetin për detyrimet që duhet të paguajë shoqëria tregtare, si për aksionarët për mosnjohjen e saktë të vlerës së aksionit, ashtu edhe për kredithënësit që duan të japin hua.

Shumë është diskutuar, rregulluar dhe përmirësuar si në kuadrin ligjor, ashtu edhe në praktikë që cilësia e pasqyrave financiare dhe vërtetësia e tyre në pasqyrimin financiar të aktivitetit të një shoqërie tregtare të certifikohet. Me gjithë përvojën e fituar ndër vite, në praktikë akoma ka probleme me hartimin e pasqyrave financiare dhe me cilësinë e tyre. Ekspertët që certifikojnë këto dokumente, nuk duhet ta bëjnë atë formalisht, papërgjegjshmëria duhet të ketë pasoja. Ata nuk mund të bëhen ortakë me pronarët duke certifikuar pasaktësitë dhe mos pasqyruar saktë gjendjen financiare të veprimtarisë. Nëse kjo ekspertizë e domosdoshme do të përmirësohet për të qenë rigorozë dhe e pa kompromentuar, do të ishte vërtet një kapërcim shumë i madh drejt formalizimit, rregullimit dhe zhvillimit të tregut, jo vetëm të kredithënies, por edhe të kapitaleve. Transparenca dhe integriteti janë bazat e besimit dhe huadhënies.

Shumë vite u përdorën si një periudhë mësimi dhe eksperience për përgatitjen e pasqyrave financiare. Në mungesë të rregullave të qarta, standardeve të pa përcaktuara plotësisht, të auditimeve në shumë raste jo profesionale, të cilësisë së ulët në ekspertizë, të dobësisë së kontrollit të pasqyrave të dorëzuara, etj., u punua me dokumentacion që linte për të dëshiruar. Bankave iu desh të përshtatnin pasqyrat financiare sipas standardeve të veta në mënyrë që të analizonin rastin për kredi. Por, që nga viti 2018, kjo praktikë është ndaluar. Pasqyrat financiare që bankat marrin në konsideratë janë të njëjta me ato që shoqëria tregtare dorëzon në zyrat e tatim-taksave. Pra, nuk ka më dy pasqyra, por vetëm një. Kjo ka rritur presionin pozitiv të shoqëritë tregtare që të pasqyrojnë sa më shumë të vërtetën, ndryshe nuk do të jenë kualifikuese në bankë në rast të kërkesës për kredi. Nga ana tjetër, kjo e ka vendosur bankën në pozitë më relaksuese, sepse nuk duhet të ribëjë grupin e pasqyrave financiare, por të fokusohet në analizë të dokumenteve të dorëzuara duke i konsideruar të vërteta. Kjo shkurton ciklin e analizës dhe kohën e vendimarrjes.

Vendimi për moslejimin të themi “të dy balance”, siç njihet në praktikë, bëri ndryshimin dhe krijon presion mbi shoqëritë tregtare për dokumentimin dhe pasqyrimin e saktë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare; ai vendos rregull në marrëdhëniet subjekt-tatime dhe subjekt – bankë.



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE (BMP) – PUBLIC OVERSIGHT BOARD (POB)

ADRESA/ADDRESS: RR. "ISMAIL QEMALI",

PALLATI NR. 5, KATI II, AP. 8, TIRANË, SHQIPËRI

TEL: +355 4 562 84 41

E-MAIL: INFO@BMP.AL

WEB-SITE: WWW.BMP.AL

FACEBOOK
LINKEDIN
TWITTER

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE – BMP
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE – BMP
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

[HTTPS://WWW.FACEBOOK.COM/BORDIMP/](https://www.facebook.com/BORDIMP/)
[HTTPS://WWW.LINKEDIN.COM/FEED/](https://www.linkedin.com/feed/)
[HTTPS://TWITTER.COM/BMP_AL](https://twitter.com/BMP_AL)